

KARTELË INFORMATIVE

AL111027

1. Emri i shërbimit	Njohja e diplomave të huaja për arsimin e mesëm (kur kërkohet për qëllim regjistrimin Institucioneve të Arsimit të Lartë ose për punësim)			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Njehsimi i diplomës së shkollës së mesme për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, për vijimin e studimeve në arsimin e lartë (Bachelor, Transferim Studimesh, Master) dhe për punësim.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Ky shërbim i mundëson qytetarit që të vijojë ndjekjen e studimeve në arsimin e lartë dhe për punësim. Produkti final që ai përfiton është dokumenti njëvlershmëri diplome e shkollës së mesme.			
4. A jam përfitues?	Shtetas shqiptarë ose të huaj të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe janë diplomuar jashtë vendit.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	Kërkesë aplikimi për njëvlershmërinë e diplomës së shkollës së mesme të përfunduar jashtë vendit, për vijimin e studimeve në ciklin e parë të studimeve, si dhe transferimet në IAL shqiptare. :			
	1	Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.	Aplikanti	Po
	2	Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dëftesave të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose në mungesë të dëftesave, kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e listës së notave të arsimit të mesëm të lartë e pajisur me vulë Apostile ose vula legalizimi sipas shtetit që i ka lëshuar	Institucion Arsimor/Noter	Po
	3	Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit e pajisur me vulë Apostile ose vula legalizimi sipas shtetit që i ka lëshuar	Institucion Arsimor/Noter	Po
	4	Kopje e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dokumentit që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.	Institucion Arsimor/Noter	Po
	Kërkesë aplikimi për njëvlershmërinë e diplomës së shkollës së mesme të përfunduar jashtë vendit, për punësimin në Republikën e Shqipërisë dhe ndjekjen e studimeve Master në IAL shqiptare:			
	1	Fotokopja e dokumentit të identifikimit të aplikantit.	Aplikanti	Po
	2	Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e dëftesave të shkollës së mesme	Institucion Arsimor/ Noter	Po
	3	Kopja e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin e diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit e pajisur me vulë Apostile ose vula legalizimi sipas shtetit që i ka lëshuar	Institucion Arsimor/ Noter	Po

	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
6. Ku mund të aplikoj?	Qendra e Shërbimeve Arsimore	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.23, Tiranë	E hënë - E enjte, ora 08.30 - 09.30; 14.30- 15.30 E Premte, ora 08.30 - 09.30
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	☐	☒	☐	☐
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë Shërbim pa pagesë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	5 ditë pune			
10. Çfarë përfitoj?	Dokumenti i njëvlershmërisë			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat			
12. Ku e marr?	Në sportele ☒	Me postë ☐	E-albania ☐	Me e-mail ☐
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Qendra e Shërbimeve Arsimore (ish AKP)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në: E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al QSHA: http://qsha.gov.al/ Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Orari Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E Hënë- E Premte, ora 08:00- 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele ☒	Me postë ☒	Web-i i Institucionit ☐	Me e-mail ☐
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		☒	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	VKM nr. 1013, datë 10.12.2010, " Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", Udhëzimi nr.44 dt.21.08.2013, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", (i ndryshuar) Ligji nr.69/2012, "Për sistemin arsimor në parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".			